

R E L A C I O N
PËR
PROJEKTLIGJIN

**“PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FONDIT KOMBËTAR
PËR ARTIN”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Fondi propozohet të krijohet si një fond special në kuptim të ligjit, që mbështet ruajtjen dhe nxit prodhimin artistik dhe veprimtaritë kulturore me interes publik, kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës kulturore publike dhe rrit aksesin dhe pjesëmarrjen e komunitetit në jetën kulturore. Në këtë kuptim, Fondi nuk ka vetëm funksion mbështetës financiar, por përbën një mekanizëm zhvillimor me ndikim afatgjatë në identitetin kulturor, kohezionin social dhe mirëqenien e komuniteteve.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektakt nuk është parashikuar në PPAP 2026 por është në përputhje me Planin Politik të Qeverisë Shqiptare dhe zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për kulturën për përmirësimin e kësaj fushe.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Kombëtar për Artin” përbën një ndërhyrje tërësore dhe të mirëstrukturuar në politikën kulturore shqiptare, duke synuar të krijojë një mekanizëm financiar të posaçëm, të qëndrueshëm dhe të mbështetur në parime moderne të qeverisjes publike. Ky projektligj parashikon ngritjen e një fondi special publik, të integruar brenda sistemit buxhetor të shtetit, i cili ka si synim kryesor mbështetjen e blerjes dhe administrimit të veprave të artit, artefakteve dhe objekteve me vlerë historike e kulturore që kanë interes publik. Duke propozuar një strukturë të re funksionale financiare, projektligji synon të forcojë kapacitetin e shtetit për të ruajtur dhe zhvilluar trashëgiminë artistike kombëtare në mënyrë të qëndrueshme.

Projektligji synon krijimin e Fondit Kombëtar për Artin si një fond që funksionon plotësisht brenda kornizës ligjore të menaxhimit financiar publik. Kjo zgjedhje shmang krijimin e strukturave burokratike shtesë dhe siguron që fondi të jetë i mbikëqyrur, transparent dhe i integruar në proceset standarde të kontrollit financiar. Kjo mbështet parimin se fondi nuk është një organizëm autonom, por një instrument publik i kontrolluar nga shteti dhe i mbikëqyrur rreptësisht.

Objektiva kryesore të këtij projektakti:

1. Pasurimi i koleksioneve publike;
2. Mbrojtja dhe rikthimi i veprave me rëndësi historike e kulturore;
3. Nxitja e krijimtarisë artistike vendase dhe ndërkombëtare;
4. Ruajtja e trashëgimisë artistike për brezat e ardhshëm.

Këto objektiva krijojnë një vizion të gjerë që shkon përtej funksionit të thjeshtë të blerjes së veprave të artit. Fondi nuk shihet vetëm si një instrument financiar, por si një mekanizëm që ndërton një politikë kulturore të qëndrueshme, të orientuar drejt mbrojtjes së identitetit kulturor dhe zhvillimit të potencialit krijues të vendit.

Miratimi i këtij projektligji parashikon disa risi si:

Krijimi i një mekanizmi të qartë institucional për administrimin dhe vendimmarrjen e fondit. Në këtë drejtim, projektligji ndan përgjegjësitë midis ministrit përgjegjës për kulturën, i cili vepron si autoritet urdhërues i fondit, dhe dy organeve të specializuara: Komisionit të blerjes së veprave të artit dhe Sekretariatit Teknik. Komisioni, i përbërë nga 3 deri në 7 anëtarë me kompetencë profesionale në fushën artistike, është organi kyç për vlerësimin e propozimeve, analizën e rëndësisë artistike, kulturore dhe financiare të veprave dhe marrjen e vendimit për blerjen. Vendimmarrja e tij duhet të jetë e dokumentuar, e arsyetuar dhe në përputhje me parimin e transparencës. Kjo strukturë e bën procesin e blerjes më profesional, më të mbrojtur nga ndikimet e jashtme dhe më të bazuar në ekspertizë.

Sekretariati Teknik, në anën tjetër, ka rol zbatues dhe koordinues. Ai merret me përgatitjen e dokumentacionit, ndjekjen e procedurave administrative dhe financiare, koordinimin me institucionet publike kulturore dhe regjistrimin e veprave në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore. Ky organizim siguron që procesi të ketë ndarje të qartë rolesh: komisioni merret me vendimmarrjen profesionale, ndërsa sekretariati me zbatimin teknik.

Një nga aspektet më inovative të projektligjit është parashikimi i burimeve të financimit të fondit. Projektligji vendos që Fondi Kombëtar për Artin të financohet në masën 10% të kursimeve të realizuara nga procedurat e prokurimit publik në nivel kombëtar, përfshirë edhe ato të prokurimeve të përqendruara nga OBP. Këto kursime, pasi verifikohen dhe konsolidohen, transferohen si të ardhura për fondin. Përveç kursimeve, projektligji parashikon donacione, sponsorizime dhe grante si burime shtesë që nuk krijojnë kosto për buxhetin e shtetit.

Projektligji i kushton rëndësi të veçantë procedurave të blerjes së veprave. Ai lejon blerje nëpërmjet ankandeve kombëtare dhe ndërkombëtare ose marrëveshjeve të drejtpërdrejta, duke njohur natyrën e veçantë të tregut të artit, i cili kërkon fleksibilitet dhe reagim të shpejtë. Në të njëjtën kohë, parashikon rregulla të forta të dokumentimit, vlerësimit të statusit juridik të veprave dhe publikimit të vendimeve. Kjo garanton që procesi të mbetet i mbrojtur nga abuzimet dhe të përputhet me interesin publik.

Rregullon pronësinë dhe administrimin e veprave pas blerjes. Çdo vepër e blerë bëhet pronë publike shtetërore dhe regjistrohet në inventarët zyrtarë të pasurive kulturore, duke u administruar nga institucionet publike përkatëse që ndjekin rregulla të qarta për ruajtjen, restaurimin dhe ekspozimin. Ky është një element themelor për garantimin e ruajtjes së vlerave kulturore brenda territorit shqiptar dhe për aksesin publik.

Vendos standarde të larta transparence, kontrolli dhe auditimi. Ministria përgjegjëse për kulturën duhet të publikojë çdo vit listën e veprave të blera dhe raportin e detajuar financiar të fondit. Po ashtu, fondi i nënshtrohet kontrollit financiar publik dhe auditimit të KLSH-së.

Sa më sipër, ky projektligj krijon një mekanizëm modern, të mbikëqyrur, të qëndrueshëm dhe të drejtë financiar për mbështetjen e artit dhe trashëgimisë kulturore në Shqipëri. Ai nuk është thjesht një instrument financiar por është një politikë e re kulturore, që e lidh kulturën me eficiencën publike, e vë profesionalizmin në qendër të vendimmarrjes dhe e konsideron artin një aset kombëtar që meriton ruajtje, dokumentim, promovim dhe investim afatgjatë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj mbështetet në nenet 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me asnjë asquis.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 24 nene si vijon:

Neni 1

Objekti i ligjit

1. Ky ligj rregullon krijimin, organizimin, funksionimin dhe administrimin financiar të Fondit Kombëtar për Artin, si fond special publik, si dhe procedurat për blerjen, administrimin dhe regjistrimin e veprave të artit dhe objekteve me vlerë historike e kulturore me interes publik.
2. Fondi Kombëtar për Artin krijohet si fond special dhe administrohet në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “*Artefakt*” është çdo objekt me vlerë historike, arkeologjike, etnografike, artistike ose dokumentare;
- b) “*Fondi*” është Fondi Kombëtar për Artin i krijuar me këtë ligj si fond special, në kuptim të ligjit nr. 9936/2008, “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- c) “*Koleksion*” është një tërësi e organizuar dhe e identifikueshme veprash arti, artefaktesh ose objektesh të tjera me vlerë artistike, historike, arkeologjike, etnografike, shkencore ose dokumentare, të mbledhura në mënyrë sistematike mbi bazën e një kriteri të përbashkët dhe që, si njësi e vetme, paraqet vlerë kulturore, studimore ose ekspozuese;
- d) “*Kursimet financiare nga prokurimet publike*” është fondi i pa shpenzuar i krijuar nga diferenca ndërmjet fondit limit të miratuar në dokumentet e prokurimit publik dhe vlerës përfundimtare kontraktuale, e vërtetuar pas

nënshkrimit të kontratës dhe pas verifikimit nga ministria përgjegjëse për financat;

- e) “*Vepër arti*” është çdo krijim original i realizuar nga një autor në fushën e arteve pamore, figurative, dekorative, digjitale ose në forma të tjera të shprehjes artistike, i cili përmban vlerë estetike, kulturore, historike ose konceptuale dhe mbrohet sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit.

Neni 3

Statusi juridik i Fondit

1. Fondi krijohet si fond special publik, pjesë përbërëse e Buxhetit të Shtetit, në kuptim të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.
2. Fondi nuk ka personalitet juridik.
3. Administrimi financiar i tij kryhet sipas legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe kontrollin financiar publik.

Neni 4

Qëllimi

Qëllimi i fondit është pasurimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave artistike e kulturore kombëtare, nëpërmjet krijimit të një mekanizmi financiar të posaçëm për blerjen e veprave të artit, artefakteve dhe veprave me vlerë historike dhe kulturore, me interes publik, të cilat nuk financohen ose nuk mbulohen nga fondet ekzistuese publike, me synim:

- a) pasurimin e koleksioneve publike kombëtare;
- b) mbrojtjen, rikthimin dhe ruajtjen në vend të veprave me rëndësi historike e kulturore;
- c) nxitjen dhe mbështetjen e krijimtarisë artistike vendase dhe ndërkombëtare;
- ç) sigurimin, ruajtjen dhe transmetimin e trashëgimisë artistike për brezat e ardhshëm.
- d) vendosjen dhe ekspozimin e veprave të blera në hapësira publike dhe institucione publike, me qëllim rritjen e aksesit të publikut.

Neni 5

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet nga ministria përgjegjëse për kulturën, ministria përgjegjëse për financat, institucionet publike kulturore, si dhe çdo strukturë tjetër publike e përfshirë në procesin e blerjes, administrimit, ruajtjes ose ekspozimit të veprave të financuara nga Fondi.

Neni 6

Subjektet e ligjit

1. Subjektet e këtij ligji janë:

- a) Individët, personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, nga të cilët blihen ose përfitohen vepra arti, artefakte dhe objekte të tjera me vlerë historike, artistike dhe kulturore, në përputhje me këtë ligj;
 - b) ministria përgjegjëse për kulturën;
 - c) ministria përgjegjëse për financat;
 - d) institucionet publike përfituese;
 - e) strukturat administrative të ngarkuara me zbatimin e Fondit.
2. Galeria Kombëtare e Arteve, në cilësinë e institucionit teknik dhe profesional, jep opinion të specializuar për vlerësimin artistik dhe mbështet proceset e përzgjedhjes, blerjes, administrimit dhe ekspozimit të veprave të artit në kuadër të Fondit të Artit dhe Kulturës.
3. Kompetencat për administrimin, vendimmarrjen dhe mbështetjen teknike të Fondit të Artit dhe Kulturës ndahen ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të parashikuara në këtë nen, funksionet dhe procedurat përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për kulturën.

Neni 7

Parime të përgjithshme

1. Fondi funksionon mbi parimet e ligjshmërisë, transparencës, interesit publik, llogaridhënies, proporcionalitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve publike.

2. Ndalohet financimi i dyfishtë publik për të njëjtin qëllim, objekt ose shpenzim.
3. Fondi funksionon mbi parimin e neutralitetit fiskal, duke u financuar vetëm nga kursimet e krijuara nga procedurat e prokurimit publik, pa cenuar balancat buxhetore dhe pa krijuar shpenzime të reja buxhetore.

KREU II ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I FONDIT

Neni 8 **Administrimi i Fondit**

1. Ministri përgjegjës për kulturën është autoriteti urdhërues i Fondit.
2. Strukturat përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për kulturën, zbatojnë administrimin buxhetor, kontabël dhe raportimin financiar.

Neni 9 **Komisioni i blerjes së veprave të artit**

1. Blerja e veprave realizohet nga një komision kolegjal i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për kulturën.
2. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 7 anëtarë, të përzgjedhur nga ekspertë vendas dhe të huaj, mbi bazën e kompetencës profesionale në fushën artistike.
3. Përjashtimi nga rregullat e prokurimit publik lejohet vetëm për shkak të natyrës unike të veprave të artit dhe shoqërohet me garanci të posaçme transparence, kontrolli financiar dhe auditimi.
4. Vendimet e komisionit janë të arsyetuara, të dokumentuara dhe bëhen publike sipas rregullave të transparencës.
5. Rregullat për përbërjen, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, përfshirjen e ekspertëve të huaj, funksionimin dhe procedurat e vendimmarrjes së Komisionit dhe sekretariati teknik miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Komisioni asistohet nga sekretariatik teknik i cili përgatit dokumentacionin administrativ dhe e përcjellë pranë strukturës përgjegjëse për blerjen dhe likuidimin financiar, bashkëpunon me institucionin përgjegjës i cili

administron regjistrin kombëtar të pasurive kulturore. Dokumentacioni administrativ dhe financiar ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Blerja e veprave

1. Blerja e veprave të artit dhe objekteve me vlerë historike realizohet sipas një procedure të veçantë, në ankande kombëtare ose ndërkombëtare, ose përmes marrëveshjeve.
2. Procedura për blerjen e veprave të artit, artefakteve dhe koleksioneve miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Pronësia dhe administrimi i veprave

1. Objektet e blera sipas këtij ligji bëhen pronë publike shtetërore dhe regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore.
2. Administrimi, ruajtja, restaurimi dhe ekspozimi i tyre realizohet nga institucionet publike përfituese, **duke përfshirë vendosjen e tyre në hapësira publike dhe institucione publike**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Rregullat për shpërndarjen, vendosjen në hapësira publike dhe administrimin e veprave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III

FINANCIMI I FONDIT

Neni 12

Burimet financiare

1. Fondi Kombëtar për Artin financohet nga kursimet buxhetore të krijuara nga procedurat e prokurimit publik të institucioneve të administratës shtetërore qendrore, të konsoliduara në Buxhetin e Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.
2. Në Fond alokohet 10% (dhjetë përqind) e kursimeve financiare të konstatuara në nivel kombëtar, në përputhje me ligjin e buxhetit.

3. Kursimet buxhetore konsiderohen përfundimtare pas përfundimit të procedurës së prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës përkatëse.
4. Kursimet financiare përfshijnë edhe ato të krijuara nga procedurat e prokurimit të përqendruar, të zhvilluara nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP).
5. Fondi nuk financohet nga burime të tjera të Buxhetit të Shtetit, përfshirë transfertat buxhetore, fondet rezervë, fondet e kontigjencës apo burime të tjera buxhetore.
6. Fondi mund të financohet gjithashtu nga donacione, sponsorizime dhe grante, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Mekanizmi i kalimit të fondeve

1. Institucionet e administratës shtetërore qendrore raportojnë cdo 3 (tre) muaj pranë ministrisë përgjegjëse për financat kursimet financiare të krijuara nga procedurat e prokurimit publik.
2. Kursimet financiare derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe nuk mbahen ose riallokohen nga institucionet përkatëse.
3. Ministria përgjegjëse për financat konsolidon kursimet e raportuara dhe përlllogarit shumën përkatëse në masën 10% , e cila alokohet për Fondin Kombëtar për Artin.
4. Shuma e përlllogaritur regjistrohet si e ardhur e Buxhetit të Shtetit dhe transferohet për përdorim të Fondit Kombëtar për Artin, në përputhje me ligjin vjetor të buxhetit.
5. Në rastet kur gjatë vitit buxhetor miratohet akt normativ me efekt financiar, Ministria përgjegjëse për financat kryen vlerësimin e kursimeve financiare të krijuara nga procedurat e prokurimit publik dhe përlllogarit fondin që do të alokohet për Fondin Kombëtar për Artin, në përputhje me parimet e unitetit dhe kontrollit financiar.
6. Procedurat e raportimit, konsolidimit dhe transferimit të fondeve përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 14

Kursimet nga procedurat e prokurimit të përqendruar

1. Në rastet kur procedurat e prokurimit publik zhvillohen nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP), kursimet financiare përcaktohet si diferenca ndërmjet fondit limit të miratuar dhe vlerës përfundimtare kontraktuale.
2. OBP evidenton dhe raporton këto kursime pranë ministrisë përgjegjëse për financat dhe institucioneve përfituese.
3. Kursimet regjistrohen në Buxhetin e Shtetit dhe përfshihen në konsolidimin e përgjithshëm të kursimeve buxhetore, sipas rregullave të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.
4. Ministria përgjegjëse për financat përfshin këto kursime në konsolidimin e përgjithshëm të kursimeve nga prokurimet publike dhe përlllogarit shumën përkatëse për Fondin, sipas nenit 14 të këtij ligji.

Neni 15

Donacionet dhe sponsorizimet

1. Fondi Kombëtar për Artin mund të përfitojë donacione dhe sponsorizime vullnetare nga subjekte publike ose private, vendase ose të huaja, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Donacionet dhe sponsorizimet:
 - a) nuk përbëjnë fonde buxhetore dhe nuk krijojnë detyrime financiare për Buxhetin e Shtetit;
 - b) derdhen dhe administrohen në një llogari të posaçme bankare, të hapur në sistemin e Thesarit të Shtetit, e veçuar nga llogaritë buxhetore të Fondit;
 - c) përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë dhënë dhe në përputhje me këtë ligj;
 - ç) nuk mund të kushtëzohen në mënyrë që cenon interesin publik, transparencën, barazinë në përfitim apo pavarësinë e vendimmarrjes.
3. Administrimi financiar, përdorimi dhe raportimi i donacioneve dhe sponsorizimeve realizohet në përputhje me rregullat e kontabilitetit publik dhe procedurat e Thesarit të Shtetit.
4. Donacionet dhe sponsorizimet raportohen veçmas në raportimin financiar vjetor të Fondit dhe i nënshtrohen kontrollit të brendshëm financiar publik dhe auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 16

Balancimi financiar i Fondit

1. Fondi balancohet çdo vit në përputhje me rregullat e balancimit buxhetor të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor.
2. Fondet e pashpenzuara në fund të vitit buxhetor mbarten në vitin pasardhës dhe përdoren vetëm për qëllimet e këtij ligji, sipas rregullave të ligjit vjetor të buxhetit.

Neni 17

Konsolidimi dhe raportimi financiar

1. Fondi Kombëtar për Artin konsolidohet në llogaritë e qeverisjes së përgjithshme, në përputhje me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe standardet kombëtare të kontabilitetit publik.
2. Fondet buxhetore të Fondit dhe fondet jo-buxhetore të përfituara nga donacionet dhe sponsorizimet administrohen dhe raportohen të ndara, në përputhje me rregullat e Thesarit të Shtetit.
3. Donacionet dhe sponsorizimet, megjithëse nuk përbëjnë fonde buxhetore, pasqyrohen për qëllime transparence, monitorimi dhe kontrolli në raportimin financiar të Fondit.
4. Raportimi financiar i Fondit, përfshirë përdorimin e fondeve nga donacionet dhe sponsorizimet, përbën pjesë përbërëse të raportimit vjetor të Buxhetit të Shtetit.

Neni 18

Mbyllja e fondit

1. Fondi Kombëtar për Artin mund të mbyllet vetëm me ligj.
2. Në rast mbylljeje, të gjitha të ardhurat e pashpenzuara, aktivet, si dhe detyrimet financiare të Fondit, transferohen dhe trajtohen sipas legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe konsolidohen në Buxhetin e Shtetit.
3. Procedurat e mbylljes financiare, inventarizimi i aktiveve dhe likuidimi i detyrimeve kryhen në përputhje me rregullat e Thesarit të Shtetit dhe legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

KREU IV

TRANSPARENCA DHEKONTROLLI

Neni 19
Transparenca

1. Ministria përgjegjëse për kulturën publikon çdo vit listën e veprave të blera të regjistruara në inventarin publik, vlerat financiare përkatëse dhe raportin e përdorimit të fondit.
2. Informacioni publikohet në format të hapur dhe të aksesueshëm për publikun, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit.

Neni 20
Shmangia e konfliktit të interesave

1. Anëtarët e komisioneve dhe strukturave zbatuese zbatojnë legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
2. Asnjë anëtar i Komisionit apo strukturave zbatuese nuk merr pjesë në shqyrtimin, vlerësimin ose vendimmarrjen për përzgjedhje ku ai vetë, familjarët e tij ose subjektet me të cilat ka lidhje interesi përfitojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Neni 21
Kontrolli dhe auditimi

Fondi i nënshtrohet kontrollit të brendshëm financiar publik dhe auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23
Aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore të parashikuara në pikën 3 të nenit 6, pikën 5 të nenit 9, pikën 2 të nenit 10, pikën 3 të nenit 11, brenda 3 (tri) muajve nga hyrja në fuqi e tij.
2. Ministri përgjegjës për financat miraton udhëzimin e parashikuar në pikën 6 të nenit 13 të këtij ligji, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ky ligj zbatohet nga ministria përgjegjëse për kulturën, ministria përgjegjëse për financat, institucionet publike kulturore, si dhe çdo strukturë tjetër publike e përfshirë në procesin e blerjes, administrimit, ruajtjes ose ekspozimit të veprave të financuara nga Fondi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga strukturat e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efekti financiar do të akordohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**MINISTRI
BLENDI GONXHJA**